



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1116/12 Prot

Tiranë, më 16/10/2023

**N J O F T I M**

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e TKOBAP-së” me nr.1850 prot datë 25.07.2014, shpall një vend vakant për pozicionin e punës:

**-Orkestrant Kategoria e Dytë (instrumenti klarinetë) në Sektorin e Orkestrës pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme, për vendin vakant Orkestrant Kategoria e Dytë (instrumenti klarinetë) në Sektorin e Orkestrës pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

**-Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje e certifikuar nga shteti;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Audicioni për këtë vend vakant do të mbahet në sallën e orkestrës së AKVP brenda ambjentëve të TKOBAP në datën 10/11/2023 ora 10:00.**

Të gjithë artistët që janë të interesuar për t'iu nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën 03.11.2023, ora 16:30 dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

**Dokumentacioni:**

1. Të jetë diplomuar në Akademinë e Arteve-dega Klarinetë (preferohet në nivelin Master);
2. Të njohë mirë karakteret popullore të Shqipërisë së Mesme, të Veriut dhe të Jugut;
3. Të ketë eksperiencë në koncerte, recitale ose në masterclass-e;
4. Preferohet që kandidatët të jenë deri në moshën 35 vjeç me qëllim uljen e moshës mesatare të artistëve që janë pjesë e Sektorit të Orkestrës të Drejtorisë Artistike të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

\*Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

**Programi artistik:**

1. Shkalla Fa+ me relativet
2. Arpezhet
3. Një pjesë e lirë nga vetë konkurenti
4. Lexim "A prima Vista"
5. Valle "Ditë feste në Tiranë"
6. Valle "Ne Gare"
7. Valle Came "Tek Burimi"
8. Kënga "Trëndafilin kur ta dhashë"
9. Kënga "Në moshën e pjekurisë"
10. Kënga "Hapi sytë e zezë"
11. Kënga "Lule të bukura ka Tirona"
12. Kënga "Hajde Gjyle"
13. Kaba për klarinetë (e lirë sipas dëshirës së konkurentit).

**Shënim:**

- Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:  
[sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al)

**MIRATOI**

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Abigeila VOSHTINA**

